




REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK



Nr. Prot.

Vlorë, më 13.10.2017

Vendim
Nr. 93, datë 13.10.2017

**PËR RIALOKIM TË KUOTAVE PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI PRANË
FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE**

Në mbështetje të nenit **85** dhe nenit **38** të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe bazuar në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Humane, nr. 720/1 prot., datë 03.10.2017, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.10.2017

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Fakultetit të Shkencave Humane me nr. 720/1 prot., datë 03.10.2017 për rialokim të kuotave për program të dytë studimi bazuar në kërkesën e Departamentit të Drejtësisë me nr. 720 prot., datë 01.10.2017 si më poshtë:
 - a. Kuotat e paplotësuara për kategoritë: "trojet", "shtetas të huaj" apo "transferimet" të parashikuara për programet e studimit "Bachelor" të ofruara nga Fakulteti i Shkencave Humane të shfrytëzohen si kuota për program të dytë studimi në "Bachelor në Drejtësi".
 - b. Këto kuota të rialokohen si vijon:
"Bachelor në Drejtësi" 10 kuota
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Dekani i Fakultetit të Shkencave Humane, Përgjegjësi i Departamentit të Drejtësisë, sekretaria mësimore e këtij departamenti.
3. Vendimi i percillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
4. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI



Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.